



EU TECHNICAL ASSISTANCE
TO CIVIL SOCIETY ORGANISATIONS
IN THE WESTERN BALKANS AND TURKEY



Dita 1: E hënë, 28 Qershor: Të drejtat e njeriut dhe barazia gjinore

Trajnim On-Line “Programi për Përfshirjen (Integrimin) e Qasjes së Bazuar në të Drejtat e Njeriut (HRBA) dhe Barazisë Gjinore për OShC-të, në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi”



Të thyejmë akullin.... Tre pyetje për pjesëmarrësit!

A keni përjetuar individualisht shkelje të të drejtave të njeriut?

Nëse po, si keni reaguar (ilustro me një shembull)?

Cila është një nga lidhjet ose arritjet e organizatës që ju përfaqësoni me të drejtat e njeriut?





EU TECHNICAL ASSISTANCE
TO CIVIL SOCIETY ORGANISATIONS
IN THE WESTERN BALKANS AND TURKEY

Të drejtat e njeriut – Çfarë duhet të dijë çdo individ?



EU TACSO 3 project is funded by the European Union





Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe në të drejta. Ata kanë arsye dhe ndërgjegje dhe duhet të sillen ndaj njëri tjetrit me frymë vëllazërimi. (Neni 1 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut)

Pa të Drejtat e Njeriut, nuk mund të shfaqim potencialin tonë.

Nuk ka një përkufizim universal të gjithëpranuar, ndërkohë që themelet për liritë dhe të drejtat e njeriut u hodhën me deklaratën Universale të Kombeve të Bashkuara:

Të drejtat e njeriut janë të drejta dhe liri të qenësishme (të pandara) për të gjitha qeniet njerëzore dhe kanë në themel të tyre dinjitetin njerëzor.





Karakteristikat e të Drejtave të Njeriut

- 1. Të Drejtat e Njeriut janë të Patjetërsueshme** – ato janë të lidhura në mënyrë të qenësishme me njerëzit dhe nuk mund pezullohen apo kufizohen, përveç në rrethana të veçanta.
 - 2. Të drejtat e njeriut janë të pandashme, të ndërvarura dhe ndërlidhura** – të drejta të ndryshme janë të lidhura dhe nuk mund të shikohen si të izoluara nga njëra tjetra. Gëzimi i një të drejte varet nga gëzimi i shumë të drejtave të tjera dhe asnjë e drejtë nuk është më e rëndësishme se pjesa tjetër. (Shembuj, tubimi dhe liria e shprehjes, liria dhe të drejtat e tjera, e drejta për të mos u diskriminuar).
 - 3. Të drejtat e njeriut janë universale** – ato i përkasin në mënyrë të barabartë të gjithë njerëzve në botë, pavarësisht dallimeve kulturore që kanë popujt në vende të ndryshme të botës.
- Dinjiteti njerëzor** dhe **Pavarësia** janë dy nga vlerat themelore që mbrohen nga të drejtat e njeriut!



Cilat janë vlerat që mbrohen nga të drejtat e njeriut?

LIRIA - nëse detyrohemi të bëjmë diçka kundër vullnetit tonë, kjo do të zhvlerësonte shpirtin njerëzor

RESPEKTI PËR TË TJERËT- mungesa e respektit ndaj dikujt nënkupton mosvlerësimin e dinjitetit individual dhe thelbësor

MOS-DISKRIMINIMI - nuk duhet të gjykojmë të drejtat dhe mundësitë e të tjerëve bazuar në karakteristikat e tyre personale.

TOLERANCA - Mungesa e tolerancës është tregues i mungesës së respektit ndaj ndryshimeve; ndërkohë që barazia nuk dërkohë që barazia nuk nënkupton trajtimin e njëjlojtë

DREJTËSIA – njerëz të barabartë që meritojnë trajtim të drejtë

PËRGJEGJSHMËRIA - respektimi i të drejtave të të tjerëve përfshin përgjegjësinë e dikujt në veprimet e tij dhe bërjen e përpjekjeve për realizimin e të drejtave të një dhe gjithë personave (psh kur drejtojmë automjetin, kur shprehim një mendim, etj) \

Si kanë evoluar të drejtat e njeriut

Besimi se të gjithë njerëzit, për shkak të humanizmit, gëzojnë të drejta dhe liri, është mjaft i ri dhe buron nga një evolucion i vlerësimit të dinjitetit njerëzor gjatë shekujve të fundit.

Ky besim i ka rrënjët në traditën e hershme dhe dokumentet e shumë kulturave. Origjina e të Drejtave të Njeriut përcaktohet në mënyrë ideale në vitin 539 para erës tonë. Kur trupat e Kirit të Madh (Persisë) pushtuan Babiloninë. Kirusi i liri skllëvërit, deklaroi se të gjithë njerëzit kishin të drejtë të zgjidhnin fenë e tyre dhe vendosi barazinë racore. Këto parime u regjistruan në një cilindër me argjilë të pjekur të njohur si Cilindri I Kirit, dispozitat e të cilit shërbyen si frymëzim për katër nenet e para të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut.

Një gur themeli në Historinë e të Drejtave të Njeriut përfaqësohet nga shpallja e Magna Charta në 1215. Fisnikët anglezë u ngritën kundër Mbretit Xhon dhe për pak e rrëzuan nga pushteti. Në këto kushte mbreti u detyrua të premtonte se nuk do të bënte asgjë kundër vullnetit të tyre. Ai firmosi një dokument që u quajt "KARTA E MADHE E LIRIVE". Ky dokument kufizonte pushtetin e mbretit dhe u mbështet në këto parime

1. **Ligji qëndron mbi mbretin**
2. **Mbreti duhet ta respektojë ligjin**
3. **Çdo qytetari i ofrohet gjykim i barabartë para ligjit, etj.**




Vijon ...

Deklarata e të Drejtave të Njeriut dhe të Qytetarit, e miratuar në 1789, nga Asambleja Kombëtare e Francës, përfaqëson një nga kartat themelore të lirive njerëzore, që përmban parimet që frymëzuan Revolucionin Francez. Vlera themelore e prezantuar nga Deklarata ishte që të gjithë “njerezit kanë lindur dhe mbeten të lirë dhe të barabartë në të drejta”, të cilat ishin specifikuar si të drejtat e lirisë, gëzimi i pronës private, paprekshmëria e personit dhe rezistenca ndaj shtypjes.

Hapat e bëra që nga koha e Kirit ishin mbresëlënëse, megjithatë shumë prej këtyre koncepteve, kur u përkthyen në politika, përjashtuan gratë, njerëzit me ngjyrë dhe anëtarët e grupeve të caktuara shoqërore, fetare, ekonomike dhe politike.

Përpjekjet konkrete për të kapërcyer këtë situatë datojnë në shekullin e 19 dhe fillimi i shek 20 për të ndaluar tregtinë e skllëvërve dhe për të kufizuar tmerret e luftës.

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, i krijuar nga Kombet e Bashkuara nën drejtimin e fuqishëm të aktivistes/politikanes Eleanor Roosevelt, tërhoqi vëmendjen e botës, duke hartuar 30 nenet që tani përbëjnë Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut (miratuar në 10 Dhjetor 1948). Deklarata iu prezantua botës, duke vepruar për herë të parë si një statut i njohur dhe i pranuar ndërkombëtarisht, si përpjekje e artikuluar e të gjitha shteteve anëtare të UN për të mbrojtur të drejtat e njeriut pas tmerreve të luftës së I dhe II Botërore.



Drejt gjeneratës së tretë të të Drejtave të Njeriut

Ndikimi i Deklaratës Universale ka qenë thelbësor (nivel të brendshëm dhe ndërkombëtar). Së bashku me Konventat Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore dhe mbi të Drejtat Civile dhe Politike ato përbëjnë "Ligj Ndërkombëtar të të Drejtave" për detyrimet e qeverive në funksion të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave dhe lirive themelore të individëve ose grupeve.

Të Drejtat e Njeriut kanë vazhduar të evoluojnë dhe, që nga themelimi i saj, Kombet e Bashkuara kanë miratuar më shumë se 20 konventa, përfshi ato për të parandaluar dhe ndaluar abuzime specifike si torturat dhe gjenocidin dhe për të mbrojtur popullatat veçanërisht të prekshme, të tilla si refugjatët (Konventa në lidhje me statusin i Refugjatëve, 1951), gratë (Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, 1979) dhe fëmijët (Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, 1989).

Një mori traktatesh dhe dokumentesh të tjera kanë zhvilluar më tej disa nga konceptet themelore që ishin përcaktuar në Deklaratën Universale origjinale, duke parashikuar kështu një gjeneratë të re të të drejtave.

Ky evoluim, rezultat i një numri faktorësh, duke ardhur pjesërisht si përgjigje ndaj


ideve progresiste në lidhje me dinjitetin njerëzor, dhe pjesërisht si rezultat i kërcënimeve dhe mundësive të reja në zhvillim. Si të drejta të gjeneratës së tretë, këto kanë qenë pasojë e një kuptimi më të thellë të llojeve të ndryshme të pengesave për përmbushjen e të drejtave të gjeneratës së parë dhe të dytë .

Ideja në bazë të brezit të tretë të të drejtave është ajo e solidaritetit dhe e të drejtave kolektive të shoqërisë ose popujve, siç është e drejta për zhvillim të qëndrueshëm, për paqe ose për një mjedis të shëndetshëm (duke marrë shkas nga varfëria ekstreme, lufta, katastrofat ekologjike dhe natyrore).



Përgjegjësitë e Shtetit

1. **Të respektojë të drejtat e njeriut** – Shtetet duhet të përmbahen nga ndërhyrja ose kufizimi i gëzimit të të drejtave të njeriut (Detyrimi negativ)
2. **Të mbrojnë të drejtat e njeriut**- kërkon që shtetet të mbrojnë individët dhe grupet nga abuzimi i të drejtave të njeriut (detyrimi pozitiv)
3. **Të bëjnë të mundur gëzimin e të drejtave të njeriut** – Shtetet duhet të marrin masa pozitive për të lehtësuar gëzimin e të drejtave themelore.





EU TECHNICAL ASSISTANCE
TO CIVIL SOCIETY ORGANISATIONS
IN THE WESTERN BALKANS AND TURKEY

Pushim i Shkurtër

15 min



terstock.com · 316127



EU TACSO 3 project is funded by the European Union



Mungesa e Ujit të Pijshëm në fshatin Visokë, Bashkia Mallakastër

Mungesa e ujit të pijshëm e lidhur me të drejtën themelore të jetës dhe të drejtën për një jetë të qetë familjare dhe private.

Procesi gjyqësor për kërkimin e të drejtave të shkelura të banorëve të Visokës zgjati rreth 8 muaj në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, e cila, konstatoi me vendim se mungesa e gjatë e ujit të pijshëm për këta shtetas ka shkaktuar dëm tek ata (kompensim). Ky është vendimi i parë gjyqësor në Shqipëri i këtij lloji dhe përbën pjesërisht model pozitiv të mbrojtjes së drejtpërdrejtë gjyqësore të individëve në nevojë (2018).

Në thelb vendimi edhe pse pranon se ka patur një dëm nuk i detyron institucionet që tu sigurojnë banorëve të fshatit furnizimin me ujë të pijshëm. Institucionet e paditura në këtë çështje janë organet shtetërore përkatëse, vendore dhe qendrore, si Bashkia Mallakastër, Ministria Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe Agjensia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizime, etj.





EU TECHNICAL ASSISTANCE
TO CIVIL SOCIETY ORGANISATIONS
IN THE WESTERN BALKANS AND TURKEY

Ndotja ne lumin Gjanicë

Mosveprimi nga ana e institucioneve përgjegjëse ka sjellë ndotje të konsiderueshme në lumin e Gjanicës, veçanërisht nga operatorët që përpunojnë naftën dhe nënproduktet e saj. KSHH përfaqësoi në Gjykatën Administrative 3 qytetarë, me qëllim nxitjen e autoriteteve publike kompetente si Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dhe Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit (ISHMPUT), si dhe ndërgjegjësimin e tyre për ushtrimin e kompetencave që ligji u ka ngarkuar, me qëllim ndërmarrjen e masave administrative ndaj operatorëve ndotës.

Kjo padi u pranua pjesërisht dhe në Korrik të vitit 2019, Gjykata Administrative vendosi, ndër të tjerash:

Detyrimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për identifikimin e operatorëve që kërcënojnë mjedisin në lumin Gjanicë

Detyrimin e palës së paditur ISHMPUT të kryejë veprimet e nevojshme për sigurimin e kontrollit shtetëror efektiv të mbrojtjes së lumit Gjanicë nga ndotja dhe dhënien e sanksioneve ndaj shkelësve.



EU TACSO 3 project is funded by the European Union





Pop Quiz nr.1





Dy nivele për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut

1. **UNIVERSAL**– në kuadër të krijimit dhe angazhimit të Kombeve të Bashkuara

2. **Rajonal**– sistemet Rajonale të Mbrojtjes

Evropian

KiE
BE
OSBE

AMERIKAN

OSHA (organizata e
shteteve amerikane,
organizatë
ndërqeveritare)

AFRIKAN

(Bashkimi Afrikan,
organizatë
ndërqeveritare)

Instrumentat Qendrore të UN (Konventat për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut)

| | |
|---------------|---|
| ICCPR | Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (1966) |
| ICESCR | Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (1966) |
| CERD | Konventa për Eleminimin e të gjitha formave të Diskriminimit(1965) |
| CEDAë | Konventa për Eleminimin e të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Grave (1979) |
| CAT | Konventa kundër Torturës dhe Trajtimit ose Dënimeve të tjera mizore, ç'njerëzore ose poshtëruese (1984) |
| CRC | Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës (1989) |
| ICRMë | Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të gjithë punonjësve migrant dhe anëtarëve të familjes së tyre (1990) |
| CRPD | Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (2006) |
| CED | Konventa për Mbrojtjen e të gjithë personave nga Zhdukjet me Forcë (2006) |



9 Komitete të Kombeve të Bashkuara

Komiteti për Eleminimin e Diskriminimit Racial (1969)

Komiteti për të Drejtat e Njeriut (1976)

Komiteti për Eleminimin e Diskriminimit ndaj Grave (1982)

Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (1985)

Komiteti kundër Torturës (1987)

Komiteti për të Drejtat e Fëmijës (1991)

Komiteti për Mbrojtjen e të gjithë Punonjësve Migrantë dhe anëtarëve të Familjeve të tyre (2003)

Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (2008)

Komiteti për Zhdukjet me Forcë (2011)

+ Nënkomiteti për Parandalimin e Torturës (2006)



Mekanizmat Monitorues

Raportet Periodike për Secilin Shtet që ka aderuar

Ankimet apo Raportimet Individuale

Japin orientime/udhëzime të përgjithshme

Mbikqyrin sipas procedurave speciale zbatimin e Konventës



Këshilli i Evropës

KiE është një organizatë ndërkombëtare e themeluar në vitin 1949 dhe pas luftës së dytë botërore për të mbrojtur të drejtat e njeriut, shtetin dhe se drejtës dhe demokracinë në Evropë

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (1950/1953) - Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ)

Shqipëria e ka ratifikuar në vitin 1996

Karta Evropiane e Rishikuar (1996) –

Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale – Shqipëria e ka ratifikuar në vitin 2002 por nuk ka pranuar ende procedurën e ankimit kolektiv

Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale dhe të Minoriteteve (1992) –

Komiteti i Ekspertëve – Shqipëria ende nuk ka aderuar

Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare (1995) –

Komitet Konsultativ – Shqipëria e ka ratifikuar në vitin 1999

Konventa e Stambollit kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës me Bazë Gjinore (2011) - GREVIO – Shqipëria e ka ratifikuar në vitin 2013

Konventa për Veprimet kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (2005) – GRETA – Shqipëria e ka ratifikuar në vitin 2007

Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Dënimin Ç'njerëzor dhe Poshtëruar (1987) – CPT – Shqipëria e ka ratifikuar në vitin 1996

Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) (1993) – Jep rekomandime politikash të përgjithshme – Vendi ynë është anëtar në këtë Komision

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ ose Gjykata e Strasburgut)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, mekanizmi që garanton mbrojtjen e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe që ka të drejtë të japë sanksione ndaj shteteve që e shkelin të drejtat dhe liritë e parashikuara në këtë Konventë.

Gjykata ka vendosur për shumë çështje shoqërore si aborti, vetëvrasja e asistuar, skllavëria në familje, mbajtja e simboleve fetare në shkolla, mbrojtja të burimeve të gazetarëve, të drejtat në fushën e

pronësisë, torturën dhe trajtimin c'njerëzor në institucionet e mbyllura, etj.



Strazimiri kundër Shqipërisë (2020)

Gjykata e Strasburgut (GJEDNJ) verejti se autoritetet shqiptare kanë dështuar prej një kohe tepër të gjatë të sigurojnë një institucion të posaçëm mjekësor për të dënuarit me sëmundje të shëndetit mendor, të cilëve ju është kufizuar liria mbi bazën e një vendimi gjyqësor për mjekimin e detyruar. Problem strukturor.

Gjykata përsëriti që ndalimi kundër torturës dhe keqtrajtimit është absolut dhe i paderogueshëm dhe se, për këtë arsye, 'mungesa e burimeve në parim nuk mund të justifikojë kushtet e mbajtjes së këtij shtetasi, të cilat janë aq të varfëra sa të arrijnë pragun e ashpërsisë që arti 3 të zbatohet '.

Gjykata është e mendimit se Shteti përgjegjës duhet të krijojë "institucionin e duhur" të specializuar për strehimin e personave si kërkuesi për përmirësimin e kushteve të jetesës.

Trajtimi farmakologjik duhet të kombinohet me forma të tjera të njohura për trajtimin terapeutik, si pjesë e një plani të individualizuar trajtimi për secilin individ. 15 000 euro plus çdo taksë e cila mund të tarifohet, për dëmin jomonetar





Prizreni kundër Shqipërisë (2019)

Fatos Prizreni u ankua për vdekjen e të vëllait të tij të dënuar, pasi ky i fundit ishte transferuar për shkak të sëmundjeve komplekse në një spital publik ku duhet të merrte mjekim. I dënuari vuante nga sëmundja e “elefantozës” dhe insuficiencës “kardiake” dhe humbi jetën në rrethana të dyshimta.

Referuar aktit mjeko-ligjor në trupin e viktimës nuk u gjendën medikamente edhe pse ai mbahej në spital, në kycet e duarve të tij u vërejtën hematoma, cka ngrinte dyshimin për mbajtjen e tij në krevat me pranga si dhe mjekët ligjor kërkuan rikzaniminim të trupit të të ndjerit nga një grup mjekësh të specialiteteve të ndryshme. Prokuroria nuk urdhëroi ri-ekspertim dhe vendosi të mos fillonte hetimet.

GJEDNJ konstatoi shkelje të garancive procedural të nenit 2 të Konventës që mbron të drejtën e jetës, për shkak të mungesës së një hetimi efektiv për vdekjen e vëllait të viktimës. Gjithashtu, u konstatua shkelje e garancive procedural të nenit 3 që ndalon torturën, për shkak të mungesës së hetimeve lidhur me pretendimet e arsyetuara të të vëllait se viktima ishte keqtrajtuar. 12,000 shpërlbim për dëmin jo pasuror.





EU TECHNICAL ASSISTANCE
TO CIVIL SOCIETY ORGANISATIONS
IN THE WESTERN BALKANS AND TURKEY

Pushim i Shkurtër

15 min



terstock.com • 316127



EU TACSO 3 project is funded by the European Union



Kufizimet e të Drejtave të Njeriut

Derogimet

Dispozitat kufizuese



Derogimet

Disa konventa të të drejtave të njeriut parashikojnë sistemin e derogimit ose të shmangies, i cili i lejon vendet anëtare të përshtasin detyrimet e tyre përkohësisht sipas konventës, në rrethana të jashtëzakonshme, si psh në kohë emergjencash publike që kërcënojnë jetën e një kombi.

Neni 15 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut

Lejon qeveritë e vendeve anëtare që në raste të jashtëzakonshme, të kenë mundësinë e shmangies, në mënyrë të përkohshme, të kufizuar dhe nën mbikqyrjen e Komitetit të Ministrave, nga detyrimet e tyre për garantimin e disa të drejtave dhe lirive të parashikuara në Konventë.

Standartet e vendosura nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut

Emergjenca Publike duhet të jetë aktuale ose e afërt.

Vazhdimësia e jetës së komunitetit duhet të rrezikohet.

Pasojat e emergjencës duhet të përfshijnë të gjithë kombin.

Kriza ose rreziku duhet të jetë i jashtëzakonshëm.

Të drejtat nga të cilat shtetet nuk mund të shmangen

Të gjitha konventat parashikojnë një listë të drejtash nga të cilat shteti nuk mund të shmanget, pra as në kohë krize apo lufte. Këto të drejta quhen ndryshe të drejta absolute.

E drejta e jetës (me përjashtime shumë specifike sikurse është lufta apo cënimi i rendit dhe sigurisë publike, ndalimi i skllavërisë, ndalimi i torturës, trajtimit ose dënimit mizor, c'njerëzor dhe poshtërues dhe ndalimi i fuqisë prapavepruese të dënimeve penale.

Të drejtat e kufizueshme

Neni 17 i Kushtetutës parashikon se “Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjestim me gjendjen që e ka diktuar. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Të drejtat që mund të kufizohen janë liria e lëvizjes, liria e mendimit, ndërgjegjes dhe besimit fetar, liria e tubimit paqësor, liria e organizimit.

Neni 10 (Liria e Shprehjes)

Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes.

Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose saksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.

Shembull i
një të drejte
që mund të
kufizohet



Covid 19 si një emergjencë publike

Justifikimi: Përhapja e shpejtë e Korona Virusit dhe rrjedhimisht rreziku për jetën dhe shëndetin si dhe barra e rëndë për shërbimet shëndetësore ndaj personave që janë mbartës të këtij virusi dhe pasojat e tij, detyroi qeveritë e disa prej shteteve anëtare të vendosjes së disa kufizimeve në jetën e përditshme .

Megjithatë, vetëm 10 nga 47 vende anëtare të KiE deklaruan gjendjen e emergjencës.

Masat kufizuese që janë aplikuar


- Kufizimi i lëvizjes / karantinë / ndalimi i udhëtimeve
- Kufizimi i të drejtave pronësore / bizneseve
- Regjimet kufizuese në institucionet e mbyllura (p.sh. institucionet e vuajtjes së dënimit, institucionet e kujdesit shoqëror, azili dhe qendrat e migrimit)
- Mbyllja e institucioneve arsimore
- Mbyllja e restoranteve dhe veprimtarive argëtuese
- Liria e tubimit
- Gjyqet e realizuara me Skype ose Video konferencë,
- Etj.

Po Shqipëria?

- Në dt.24 Mars të 2020, Qeveria Shqiptare shpalli gjendjen e fatkeqësisë natyrore e cila zgjati tre muaj. Por kufizimet vijuan dhe më pas.
- Masat kufizuese të marra për mbrojtjen e shëndetit ndikuan në të drejtat dhe jetën e të gjithë njerëzve dhe pasojat pritet të jenë më afatgjata në kohë.
- Gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore, Shqipëria derogoi zyrtarisht nga disa nene të KEDNJ si: liria e lëvizjes, liria e tubimit, e drejta për jetë private dhe familjare, e drejta e pronës dhe e drejta për edukim.
- Puna e administratës publike dhe sistemit gjyqësor u ndikua ndjeshëm, dhe për rrjedhojë të drejta si e drejta për një proces të rregullt ligjor, e drejta e informimit dhe e drejta e konsultimit publik, edhe pse nuk u kufizuan zyrtarisht, shënuan raste të shkeljeve.
- Puna e gazetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile u vështirësua për shkak të kufizimit të mundësisë për të monitoruar dhe kryer kontroll të fakteve.

2 grupe/ 2 tema

- 10 min për diskutim
- 3 minuta për prezantim
- Ndarja e roleve:
 - a) një person do masë kohën,
 - b) një do drejtojë diskutimet,
 - c) një do mbajë shënimet dhe pasqyrojë konkluzionet





Temat për diskutim

Grupi i pare: Si u ndjetë gjatë karantinës dhe cilat të drejta vlerësoni se ju janë shkelur? A ishin kufizimet proporcionale?

Grupi i dyte: A jeni njohur me ndryshimet ligjore që janë bërë gjatë periudhës së pandemisë? A jeni konsultuar dhe keni dhënë mendim për to? A ka legjislacion në vendin tuaj që garanton konsultimin publik?



EU TECHNICAL ASSISTANCE
TO CIVIL SOCIETY ORGANISATIONS
IN THE WESTERN BALKANS AND TURKEY

Pushim i Shkurtër

15 min



terstock.com • 316127



EU TACSO 3 project is funded by the European Union





Diskutim i Hapur (20 min)

Në vlerësimin tuaj, çfarë është Qasja e Bazuar tek të Drejtat e Njeriut?





Qasja e Bazuar tek të Drejtat e Njeriut(HRBA)

HRBA është një metodologji pune e bazuar në të drejtat e njeriut të njohura ndërkombëtarisht. Elementët që e karakterizojnë këtë qasje janë si vijon:

- a) Synon të promovojë, mbrojë dhe të bëjë të mundur realizimin e të drejtave të njeriut dhe demokracisë në praktikë.
- b) Përfshin rregulla, standarte dhe parime të legjislacionit ndërkombëtar në fushën e të drejtave të njeriut në planet dhe proceset e

zhvillimit të programeve.

- c) Aplikohet në të gjithë sektorët, modalitetet dhe hapat e ciklit të **programeve**.
- d) Në themelet e HRBA është njohja se marrëdhëniet e pabarabarta të pushtetit dhe përjashtimi social u mohojnë njerëzve të drejtat e tyre njerëzore dhe i mbajnë ata në varfëri. Qasja vë theks të fortë në grupe të marginalizuara dhe të diskriminuara.

Mbajtësit e të drejtave përkundrejt mbartësve të detyrimeve

HRBA të mundëson të përqëndrohesh se në cilat të drejtat je i orientuar, kujt i përkasin ato si dhe cilët janë mbajtësit e detyrimeve që duhet të përmbushin këto të drejta.

Mbajtësit të të drejtave – çdo individ që gëzon të drejta njerëzore të patjetërsueshme. HRBA synon ti fuqizojë ata të njohin dhe të kërkojnë të drejtat e tyre si dhe të kërkojnë zhdëmtim nëse janë cenuar në këto të drejta.

Mbartësi kryesor i detyrimeve është Shteti, që ndërmerr angazhimet duke ratifikuar konventat ndërkombëtare. HRBA synon të fuqizojë kapacitetet e aktorëve shtetërorë për ti përmbushur këto detyrime.



Elementët e nevojshëm për të zbatuar HRBA-në

- Kërkohej analizë dhe vlerësim me qëllim që të identifikohen ankesat/nevojat për të drejtat e njeriut nga mbajtësit e tyre si dhe detyrimet që i korrespondojnë lidhur me to mbartësve të tyre.
- Kërkohej vlerësim dhe analizë për të identifikuar shkaqet e menjëhershme, themelore dhe strukturore për mos realizimin e të drejtave të njeriut.
- Kërkohej hartimi i programeve që përfshin vlerësimin e kapaciteteve të mbajtësve të të drejtave për të kërkuar të drejtat e tyre si dhe të mbartësve të detyrimeve për të përmbushur detyrimet e tyre.
- Kërkohej zhvillimi i strategjive për të fuqizuar kapacitetet e mbajtësve të të drejtave dhe mbartësve të detyrimeve.
- Monitorimi dhe vlerësimi i programeve kërkon ndjekjen e procesit dhe të rezultateve si dhe integrimin e aspekteve të parimeve të punës në matricën e rezultateve dhe sistemin e monitorimit.



Diskutim i Hapur



Prezantimi i Temës

- **Në fokus të drejtat e shtetasve që jetojnë në kushtet e varfërisë.**
- A ka aktivizim dhe organizim të ndjeshëm të këtyre grupeve?
- A ka mundësi për mbajtësit e të drejtave, sipas grupeve të ndara, të ndikojnë në formulimin e problemeve, planifikim, ndjekje të ndërhyrjeve të propozuara?
- Cilat do të ishte ndërhyrja që do nevojitej për ti fuqizuar nga ju si organizata?
- Cilët janë mbartësit e detyrimeve të këtyre grupeve, cilat janë nevojat, dhe në c'drejtim mund të fuqizohen ata?
-



EU TECHNICAL ASSISTANCE
TO CIVIL SOCIETY ORGANISATIONS
IN THE WESTERN BALKANS AND TURKEY

Konkluzionet kryesore

Cila është njohuria që ju
ka bërë më shumë
përshtypje ose mund
t'ju vlejë apo frymëzojë
në punën tuaj?



EU TACSO 3 project is funded by the European Union

